

VENDIM
Nr.930, datë 17.11.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT TË PRIVILEGJEVE DHE
IMUNITETEVE, TË QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË EUROPËN JUGLINDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të protokollit të privilegjeve dhe imuniteteve, të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLLI
**MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË EUROPËN
JUGLINDORE**

Palët e këtij Protokolli, duke pasur parasysh se Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, bërë në Bukuresht, Rumani, më 9 dhjetor 2009, parashikon që shtetet anëtare të lidhin një Protokoll mbi privilegjet dhe imunitetet e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij Protokolli:

- a) “Konventa e SELEC” nënkupton Konventën e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, bërë në Bukuresht, Rumani, më 9 dhjetor 2009;
- b) “SELEC” nënkupton Qendrën e Zbatimit të Ligjit në Europën Juglindore;
- c) “Vendi pritës” nënkupton vendin ku ndodhet selia e SELEC-it;
- d) “Përfaqësuesit e shteteve anëtare” nënkupton anëtarët e delegacioneve shtetërore që marrin pjesë në mbledhjet e thirrura nga SELEC-i;
- e) “Stafi i SELEC” nënkupton të gjithë personat që punojnë nën drejtimin dhe kontrollin e drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorëve të tjerë;
- f) “Drejtori i përgjithshëm” nënkupton drejtorin e përgjithshëm të SELEC-it;
- g) “Drejtorët” nënkupton drejtorët e tjerë të SELEC-it;
- h) “Koordinatorët” nënkupton punonjësit e emëruar në zyrat e SELEC-it nga shtetet anëtare;
- i) “Mbledhje e thirrur nga SELEC-it” nënkupton çdo mbledhje të çdo organi të SELEC-it ose organi në varësi apo çdo konference e thirrur nga SELEC-i;

j) “Pronë” nënkupton të gjitha të ardhurat e SELEC-it dhe të gjitha pronat e saj, duke përfshirë fondet, asetet dhe pasuritë e tjera që i takojnë SELEC-it, qoftë ato në pronësi të SELEC-it apo në administrim apo që mbahen nga SELEC-i në përputhje me detyrat zyrtare të kryera nga SELEC-i;

k) “Ambientet” nënkupton godinat ose pjesë të godinave, duke përfshirë truallin në vartësi të tyre që shfrytëzohen vetëm për qëllim të SELEC-it pavarësisht pronësisë së tyre;

l) “Arkivat” nënkupton të gjitha dosjet, raportet, korrespondencën, dokumentet, dorëshkrimet, informacione kompjuterike dhe mediatike, fotografi, filma, video, regjistrime zanore dhe çdo të dhënë tjetër që i takon apo mbahet nga SELEC-i.

Neni 2

Zbatimi i Protokollit

SELEC-i do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet përkatëse të Palëve për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë dhe parandalon çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna sipas dispozitave të këtij Protokollit.

KREU II

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SELEC-IT

Neni 3

Imuniteti ndaj një procesi ligjor

1. SELEC dhe pronat e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesi ligjor me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë kur Këshilli, me vendim të tij, autorizon heqjen e këtij imuniteti. Asnjë heqje e tillë e imunitetit nuk do të shtrihet në ndonjë masë ekzekutimi për të cilën do të jetë e nevojshme një heqje e veçantë e imunitetit.

2. Pa cenuar paragrafin e mësipërm, SELEC-i nuk do të gëzojë imunitet në lidhje me:

a) një padi civile në bazë të një detyrimi kontraktual të SELEC-it;

b) një kundërpadi të lidhur drejtpërdrejt me procedimet ligjore të filluara nga SELEC-i;

c) një padi civile në lidhje me shkelje të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale që përcaktohen në Konventën e SELEC-it;

d) një padi civile për dëmet e rezultuara nga një aksident i shkaktuar nga një automjet, anije apo avion që i përket ose që operon në emër të SELEC-it kur këto dëme nuk mbulohen nga sigurimet.

Neni 4

Paprekshmëria

1. Ambientet e SELEC-it janë të paprekshme. Pronat e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, kanë imunitet nga çdo kontroll, kërkesë, konfiskim, shpronësim apo çdo formë tjetër ndërhyrjeje, qofshin akte ekzekutive, administrative, gjyqësore apo legjislative.

2. Arkivat e SELEC-it janë të paprekshme kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen.

Neni 5

Flamuri dhe emblema

SELEC ka të drejtë të ekspozojë flamurin dhe emblemën e saj në ambientet e veta dhe në mjetet e saj të transportit kur përdoren për qëllime zyrtare. Flamujt e vendeve anëtare vendosen në ambientet e SELEC-it.

Neni 6

Lehtësirat dhe imunitetet në lidhje me komunikimet dhe publikimet

1. Palët lejojnë SELEC-in të komunikojë lirisht dhe pa nevojën për të marrë lejë të veçantë për të gjitha qëllimet zyrtare, dhe mbrojnë të drejtat e SELEC-it për të vepruar kështu. SELEC-i ka të drejtë të përdorë sisteme të fshehta, si edhe kode të ndryshme për të dërguar dhe marrë korrespondencat zyrtare dhe komunikimet e tjera zyrtare nëpërmjet korrierëve apo në çanta të vulosura, të cilat u nënshtrohen të njëjtave privilegje dhe imunitete si ato për korrierët dhe çantat diplomatike.

2. SELEC-i për komunikimet e saj zyrtare, gëzon trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Palët për misionet diplomatike të çdo shteti.

3. Palët njohin të drejtën e SELEC-it për të publikuar brenda territorit të tyre për qëllimet e përcaktuara në Konventën e SELEC-it. Të gjitha komunikimet zyrtare të drejtuara për SELEC-in dhe të gjitha njoftimet zyrtare të jashtme të lëshuara nga SELEC-i, të transmentuara nëpërmjet çdo forme e mjeti janë të paprekshme.

Neni 7

Përgjashtime

1. Brenda objektit të veprimtarisë së saj zyrtare, SELEC-i dhe pronat e saj përgjashtohen nga:

a) të gjitha taksat direkte të vendosura nga autoritetet kombëtare, rajonale apo lokale; por ka një mirëkuptim që SELEC-i nuk do të kërkojë të përgjashtohet nga tarifatat, taksat apo pagesat të cilat nuk janë gjë tjetër veç detyrime për shërbimet e ndryshme publike e komunale;

b) taksat doganore, ndalimet apo kufizimet në importin apo eksportin e mallrave për përdorim zyrtar, me kusht që mallrat e importuara të mos shiten apo disponohen ndryshe në territorin e Palës në fjalë, me përgjashtimet sipas kushteve të miratuara nga ajo Palë;

c) taksat doganore, ndalimet apo kufizimet për importin apo eksportin e publikimeve për qëllime zyrtare;

d) taksimet indirekte për mallrat dhe shërbimet e siguruar për qëllime zyrtare, duke përfshirë TVSH-në mbi këto mallra dhe shërbime, sipas të njëjtave kushte që aplikohen për misionet diplomatike në territorin e Palës në fjalë.

2. Përgjashtimet e parashikuara në paragrafin 1, pika d e këtij neni mund të jepen nëpërmjet një kompensimi sipas procedurave të njëjta që aplikohen për misionet diplomatike në territorin e Palës në fjalë.

Neni 8

Lirimi i aseteve financiare nga kufizimet

Duke mos qenë objekt i asnjë kontrolli financiar apo moratoriumi të çfarëdo lloji, brenda territorit të palëve, SELEC-i është i lirë:

a) të blejë nëpërmjet kanaleve të autorizuara çdo monedhë dhe t'i mbajë ose t'i shesë ato;

b) të operojë llogari bankare në çdo monedhë.

KREU III

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E PERSONAVE TË ANGAZHUAR ME PUNË NË SELEC

Neni 9

Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të shteteve anëtare

1. Përfaqësuesit e shteteve anëtare, gjatë kohës së ushtrimit të misionit të tyre në SELEC dhe gjatë udhëtimeve të tyre për dhe nga vendet e mbledhjeve të organizuara nga SELEC-i, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitetin ndaj arrestimit apo ndalimit të personit dhe sekuestrimit të bagazheve të tyre personale;

b) imunitetin ndaj çdo lloji procesi ligjor në lidhje me fjalët e shprehura apo të shkruara dhe

për të gjitha veprimet e kryera nga ta në cilësinë e tyre si përfaqësues; ky imunitet do të vazhdojë të akordohet pavarësisht se personat në fjalë mund të kenë pushuar ushtrimin e funksioneve të tyre si përfaqësues;

c) paprekshmërinë e dokumentacionit zyrtar, informacioneve dhe materialeve të tjera zyrtare në zotërim të tyre;

d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë dokumente e korrespondenca me korrier apo në çanta të vulosura;

e) përjashtimi i vetë atyre dhe i bashkëshortëve nga kufizimet e emigracionit dhe formaliteteve për regjistrimin e shtetasve të huaj në vendin e Palës që vizitojnë apo kalojnë tranzit për ushtrimin e funksioneve të tyre;

f) të njëjtat lehtësira në lidhje me monedhat apo kufizimet në konvertimin e tyre, siç u akordohen përfaqësuesve të qeverive të huaja në misionet e tyre zyrtare të përkohshme;

g) të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tyre personale, siç u akordohen agjentëve diplomatikë;

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të aplikohet ndërmjet një përfaqësuesi dhe shtetit anëtar nga i cili ai/ajo është shtetas apo rezident i përhershëm apo ai/ajo është ose ka qenë përfaqësues.

Neni 10

Privilegjet dhe imunitetet e koordinatorëve

1. Në vendet pritëse, koordinatorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë e këtyre familjeve, u akordohen privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat që u akordohen agjentëve diplomatikë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961.

2. Koordinatorët nuk angazhohen në asnjë veprimtari fitimprurëse në vendet pritëse, përveç atyre që rezultojnë nga funksionet e tyre në SELEC.

3. Koordinatorët që janë shtetas apo rezidentë të përhershëm në vendin pritës gëzojnë imunitet ndaj çdo procesi ligjor dhe janë të paprekshëm vetëm në lidhje me veprimet zyrtare që kryhen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

4. Në territorin e Palëve, veç vendit pritës, koordinatorët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të lidhur me punën në SELEC, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që aplikohen për përfaqësuesit e shteteve anëtare, siç përcaktohet në nenin 9, me përjashtim të pikave e dhe g të nenit 9, paragrafi 1.

Neni 11

Privilegjet dhe imunitetet e drejtorit të përgjithshëm, drejtorëve dhe stafit të SELEC-it

1. Drejtori i përgjithshëm, drejtorët dhe stafi i SELEC-it:

a) do të jenë të imunizuar nga çdo proces ligjor edhe pas përfundimit të punës së tyre në SELEC në lidhje me fjalët e shprehura ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera nga ta në funksionet e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të kompetencave të tyre;

b) do të përjashtohen nga taksimi i rrogave, shpërblimeve dhe pagesave që SELEC-i u bën atyre;

c) do të përjashtohen, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, nga kufizimet e emigracionit dhe formalitetet për regjistrimin e shtetasve të huaj;

d) do të akordohen të njëjtat lehtësira në lidhje me monedhat dhe kufizimet në konvertimin e tyre siç u akordohen anëtarëve në nivele të krahasueshme me ato të misionëve diplomatike;

e) do t'u jepen, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, të njëjtat lehtësira riatdhesimi në kohën e krizave ndërkombëtare, siç u akordohen anëtarëve të nivelit të krahasueshëm të misionëve diplomatike;

f) do të kenë të drejtë, në vendin pritës, në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij, për të importuar pa taksa doganore mobilitet dhe sendet e tyre personale, duke përfshirë një automjet, në kohën kur fillojnë për herë të parë punën në postin e caktuar dhe kanë të drejtë t'i eksportojnë ato pa taksa doganore kur përfundojnë funksionin e tyre në SELEC;

g) nuk janë të detyruar të japin të dhëna si dëshmitarë në lidhje me detyrat e tyre zyrtare; dhe
h) do të gëzojnë paprekshmëri për të gjitha shkresat, dokumentacionin dhe materialet e tjera zyrtare në lidhje me SELEC-in.

2. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorëve të tjerë iu akordohen në vendin pritës, vetë atyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat që iu akordohen agjentëve diplomatikë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961.

3. Privilegjet dhe imunitetet e drejtorit të përgjithshëm, drejtorëve të tjerë dhe stafit të SELEC-it të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, pikat “b” deri te “f” dhe në paragrafin 2 të këtij neni, nuk do të aplikohen në lidhje me Palën nga e cila personi është shtetas apo rezident i përhershëm.

Neni 12

Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të partnerëve operacionalë

Përfaqësuesit e partnerëve operacionalë që vendosen në SELEC në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi u akordohen privilegje dhe imunitete, siç u akordohen koordinatorëve të shteteve anëtare në atë masë që këto privilegje dhe imunitete kufizohen në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet partnerëve operacionalë dhe SELEC-it.

Neni 13

Njoftimet

1. Secila Palë i njofton drejtorit të përgjithshëm dhe depozitarit emrat dhe pozicionet/funksionet e përfaqësuesve të saj dhe të koordinatorëve, si dhe anëtarët e familjes së koordinatorëve që janë anëtarë të familjes.

2. Secili partner operacional i njofton drejtorit të përgjithshëm dhe depozitarit emrat e përfaqësuesve të tij.

3. Drejtori i përgjithshëm përcakton në një listë të përditësuar që i komunikohet secilës Palë emrat dhe funksionet e personave të renditur më poshtë:

- a) Drejtori i përgjithshëm;
- b) Drejtorët;
- c) Anëtarët e stafit të SELEC-it;
- d) Koordinatorët; dhe
- e) Përfaqësuesit e partnerëve operacionalë.

Neni 14

Hyrja, qëndrimi, largimi dhe tranziti

Palët krijojnë lehtësira, kur është e nevojshme, për hyrjen dhe qëndrimin në territorin e një Pale dhe nuk krijojnë asnjë pengesë për largimin nga ajo Palë të personave të renditur më poshtë kur kjo hyrje apo ky qëndrim lidhet me aktivitetet zyrtare të SELEC-it dhe merr masa që atyre të mos u krijohet asnjë pengesë gjatë kalimit tranzit për ose nga vendi ku ata kanë një punë zyrtare të lidhur me SELEC-in:

- a) Përfaqësuesit e shteteve anëtare;
- b) Koordinatorët; dhe
- c) Drejtori i përgjithshëm, drejtorët dhe stafi i SELEC-it.

Neni 15

Kohëzgjatja e privilegjeve dhe imuniteteve

1. Në territorin e vendit pritës, çdo person që ka të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me këtë titull do t'i gëzojë këto privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai/ajo hyn në

vendin pritës për të kryer procedurat e marrjes së detyrës së saj/tij, ose, nëse ndodhet aktualisht në vendin pritës, nga momenti kur autoritetet kompetente të vendit pritës njoftohen për mbërritjen e tij/e saj nga Pala dërguese. Kur këta persona e përfundojnë detyrën e tyre, privilegjet dhe imunitete që ata gëzojnë në vendin pritës normalisht ndërpriten në momentin kur ata largohen nga vendi pritës, ose me skadimin e një afati të arsyeshëm për ta bërë këtë. Megjithatë, në lidhje me veprimet e kryera nga këta persona në ushtrimin e funksioneve të tyre, imuniteti do të vazhdojë të veprojë.

2. Gjatë ushtrimit të punës zyrtare të saj/tij në lidhje me SELEC-in në territorin e Palëve përveç vendit pritës, çdo person që ka të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me këtë të drejtë do të gëzojë këto privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai/ajo hyn në territorin e Palës në fjalë dhe gjatë qëndrimit të tij/saj në territorin e kësaj Pale. Megjithatë, kuptohet se asgjë në këtë protokoll nuk do të pengojë autoritetet përkatëse të Palëve të kërkojnë të dhëna të arsyeshme nga SELEC-i ku të konfirmohet se personat që pretendojnë trajtimin e përcaktuar në këtë protokoll po udhëtojnë për punë zyrtare të SELEC-it.

Neni 16

Kufizimi i imuniteteve

Imuniteti ndaj proceseve ligjore nuk aplikohet në lidhje me një padi civile për dëmet e rezultuara nga një aksident në territorin e një Pale të shkakuar nga një automjet, anije ose avion që përdoret nga çdo përfaqësues i një shteti anëtar, nga koordinatorët, drejtorin e përgjithshëm, drejtorët, anëtarët e stafit të SELEC-it, ose përfaqësuesit e një partneri operacional, dhe as imuniteti nga një proces ligjor nuk aplikohet në lidhje me një shkelje të rregullave të trafikut.

Neni 17

Heqja e imuniteteve

1. Privilegjet dhe imunitetet në këtë protokoll akordohen jo për përfitime personale të vetë personave, por me qëllim që të sigurohet ushtrimi i pavarur i funksioneve të tyre në lidhje me SELEC-in.

2. Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla në përputhje me këtë protokoll, të respektojnë ligjet dhe rregullat e vendit pritës dhe të Palëve të tjera.

3. Kompetencat për heqjen e imunitetit janë si më poshtë:

a) në lidhje me përfaqësuesit dhe koordinatorët e shteteve anëtare heqja e imunitetit do të jetë në kompetencë të Palës dërguese. Kjo Palë do të ketë të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të saj, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe nuk do të cenonte qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti;

b) në lidhje me drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorët, Këshilli do të ketë të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin kur imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e SELEC-it;

c) në lidhje me ndonjë anëtar të stafit të SELEC-it, drejtorin e përgjithshëm do të ketë të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit kur imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e SELEC-it;

d) në lidhje me përfaqësuesit e një partneri operacional, heqja e imunitetit do të jetë në kompetencë të partnerit operacional dërgues. Ky partner operacional ka të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe nuk do të cenonte qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti.

4. Asnjë heqje e tillë imuniteti nuk shtrihet te ndonjë masë ekzekutimi për të cilën është e nevojshme heqje imuniteti e veçantë.

5. SELEC-i do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet kompetente të Palëve dhe të partnerëve operacionalë, me qëllim që të lehtësojë administrimin e duhur të drejtësisë dhe të parandalojë çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna në bazë të dispozitave të këtij protokolli.

KREU IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga shtetet nënshkruese në Konventën e SELEC-it.
2. Ky Protokoll është subjekt ratifikimi, pranimi apo miratimi nga shtetet nënshkruese, në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.
3. Pas hyrjes së saj në fuqi, çdo Palë tjetër në Konventën e SELEC-it mund të aderojë në këtë protokoll.
4. Dokumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te depozitari.

Neni 19

Rezervat

Këtij Protokollit nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 20

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e protokollit

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës kur nëntë shtete nënshkruese të kenë depozituar dokumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit.
2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll pas datës së hyrjes së tij në fuqi, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit nga ai shtet të instrumenteve përkatëse.
3. Ky Protokoll do të mbetet në fuqi për aq kohë sa të jetë në fuqi Konventa e SELEC-it.

Neni 21

Ndryshimet

1. Ky Protokoll mund të ndryshohet me propozim të çdo Pale.
2. Çdo propozim i tillë u komunikohet palëve nga drejtori i përgjithshëm të paktën gjashtë muaj para dorëzimit të tij në Këshill për shqyrtim dhe miratim.
3. Ndryshimet e këtij Protokollit, të miratuara në përputhje me paragrafin 2 të mësipërm janë subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga Palët dhe hyjnë në fuqi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 20.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve ose ndërmjet një pale dhe SELEC-it në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokollit, palët e interesuara do të përpiqen t'i zgjidhin nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve të ndërsjella. Nëse këto konsultime dhe bisedime nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda gjashtë muajve, palët do t'ia paraqesin çështjen Këshillit për shqyrtim dhe veprimet e nevojshme.

Neni 23

Tërheqja

1. Çdo Palë mund të tërhiqet nga ky Protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim

dërguar sekretariatit të SELEC-it dhe depozitarit, i cili më pas i dërgon një kopje të vërtetuar të këtij njoftimi secilës Palë.

2. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa e SELEC-it në bazë të procedurave të përcaktuara në nenin 51 të kësaj Konvente, tërhiqet në të njëjtën kohë nga ky Protokoll.

3. Tërheqja bëhet e vlefshme tre muaj pas datës në të cilën depozitari merr njoftimin.

Neni 24

Depozitari

1. Qeveria e Rumanisë vepron si depozitari i këtij protokolli.

2. Depozitari i dërgon një kopje të vërtetuar me origjinalin sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Origjinali i këtij Protokolli, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, depozitohet te depozitari, i cili i dërgon secilës palë një kopje të vërtetuar.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në _____ më _____